

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së Ambasadës Amerikane, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Iirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Y. Merkaj, E. Allushi**
- **Parti Politike:**      **S’ka**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita! Fillojmë seancën publike për shqyrtimin e një çështjeje që kemi në rendin e ditës, kërkesën “Për akreditim të vëzhguesve për zgjedhjet e 6 marsit, nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës”. Po, Ermina!

**Znj. E. Allushi:** Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 4 vëzhgues afatshkurtër dhe 4 përkthyes, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës është një subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhjet, të përcaktuara në nenin 6, pika 2 e Kodit Zgjedhor. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 03.03.2022*

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Atëherë miratohet kërkesa e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për akreditimin e 4 vëzhguesve afatshkurtër dhe 4 përkthyesve të kësaj ambasade, për vëzhgimin e zgjedhjeve të datës 6 Mars 2022. Kërkesa të tjera për akreditim? Nuk kemi!

**Znj. E. Allushi:** Jo! Kjo ishte e fundit!

**Z. I. Celibashi:** Në rregull! Nëse do ketë kërkesa të tjera do t'i bëjmë po prapë sot.

**Znj. E. Allushi:** Po, sot është afati i fundit.

**Z. I. Celibashi:** Në rregull, dakord! Kështu që ndoshta mund të kemi dhe për nesër ndonjë kërkesë për ta shqyrtuar?

**Znj. E. Allushi:** Po, deri ditën e sotme presim kërkesat.

**Z. I. Celibashi:** Në rregull! Mirë, faleminderit, seanca mbyllet! Ditën e mirë!

**Vendim nr. 118**

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*

